



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN KRYESISHT TË SEKRETARIT TË KZAZ NR. 74, LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARIT TË KZAZ NR. 70, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.05.2019, me pjesëmarrjen e:

| | | |
|---------|----------|------------|
| Klement | ZGURI | Kryetar |
| Denar | BIBA | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI | Anëtare |
| Rezarta | BITRI | Anëtare |

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Lirimin dhe emërimin kryesisht të sekretarit të KZAZ nr. 74, lirimin dhe emërimin e anëtarit të KZAZ 70, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 29, pika 5, neni 30, neni 31, neni 32 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Me shkresën nr. 4094 prot., datë 21.05.2019, sekretarja e emëruar kryesisht nga KQZ për plotësim të vakancës në KZAZ nr. 74, zj. Denisa Hoxha, ka deklaruar dorëheqjen nga detyra për shkaqet e parashikuara në nenin 32, germa "a", të Kodit Zgjedhor.

Në listën e shtetasve miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 9.04.2019, pas plotësimit të vakancave të KZAZ me emërimet kryesisht nga KQZ, rezultojnë të pa emëruar 232 shtetas.



Në listën e miratuar me vendim të KQZ-së, rezultojnë tre shtetas me vendbanim në Bashkinë Përmet të pa emëruar kryesisht nga KQZ. Asnjë prej tyre nuk është me arsim juridik, dhe nuk përmbush kushtin e nenit 31, pika b, për t'u emëruar kryesisht sekretar i KZAZ nr. 74.

Në shqyrtim të kërkesave të shtetasve në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, por që për shkak të paraqitjes në tejkalim të afatit të përcaktuar, nuk janë bërë pjesë e lidhjes 1 të vendimit nr. 140, datë 09.04.2019, rezulton se plotëson kriteret e nenit 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor për plotësim të vakancës në KZAZ nr. 74, z. Drini Murataj.

Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr. 4115 prot., datë 21.05.2019, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, kërkon lirim e anëtarit të KZAZ 70, Z. Denis Shaholli, dhe emërim në këtë detyrë të z. Jonel Demirali Kambo.

Kërkesa dhe propozimi i paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, janë në përputhje me kërkesat e nenit 30, 31 dhe 32 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 29, pika 5, nenin 30, nenin 31, nenin 32, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra sekretaren e KZAZ-së nr.74, zj. Denisa Fatos Hoxha, Bashkia Përmet, dhe anëtarin e KZAZ-së nr. 70 z. Denis Ramadan Shaholli, Bashkia Devoll.
2. Të emërojë kryesisht sekretarin e KZAZ-së nr.74, Z. Drini Reshat Murataj, Bashkia Përmet, dhe anëtarin e KZAZ nr. 70, z. Jonel Demirali Kambo, Bashkia Devoll.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

| | | |
|----------------|-----------------|-------------------|
| Klement | ZGURI | Kryetar |
| Denar | BIBA | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI | Anëtare |
| Rezarta | BITRI | Anëtare |



Nr. 609 i Vendimit Data 21.05.2019 e Vendimit Ora 19:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërim kryesisht të sekretarit të KZAZ nr. 74, lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ nr. 70, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.